

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT
TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS
PER AKTIVITETIN:

**“TREGTIMI DHE MAGAZINIMI I
NAFTES DHE NENPRODUKTEVE
TE SAJ ME SHUMICE ”**

Vendodhja : Zona portuale Durres “Porto Romano”, fshati Rinia, Njesia Administrative Katund i Ri, Bashkia Durres, Qarku Durres.

Kërkues: Subjekti: “EUROPETROL EXPORT ”
shpk

Hartoi raportin:

“ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS” Sh.p.k

(Çert. Nr. 551 Prot, dt. 24.10.2008)

Administrator
Elidiana Shehu



emcstudio
Environmental Management Consultants Ltd

Gusht, 2021

PERMBLEDHJE

1.1. Hyrje

Objekti i raportit të përmbledhur të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është projekti **“Magazinimi dhe tregtimi i naftes dhe nenprodukteve të saj me shumice ”**, me vendodhje “Porto Romano”, fshati Rinia, Njesia Administrative Katund i Ri, Bashkia Durrës, Qarku Durrës. është:

- Përcaktimi, përshkrimi dhe vlerësimi i ndikimeve të pritshme mjedisore lidhur me funksionimin e këtij aktiviteti.
- Propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve negative në mjedis.

1.2. Karakteristikat e projektit, të dhëna të përgjithshme

Shoqëria “EUROPETROL EXPORT ” Sh.pa me NIPT L82323501B, me seli në Porto Romano Durrës , dhe me administrator Arlind Fida .

Ky aktivitet është egzistues dhe ushtrohet në zonën industriale “Porto Romano”, Durrës. Aktiviteti i tregtimit me shumice të depozitave të karburanteve në këtë zonë është një aktivitet egzistues me leje ndërtimi dhe regjistrim në ZVRPP referuar këtij destinacioni.

Investimi egzistues i tregtimit me shumice të hidrokarbureve është i pajisur me të gjitha certifikimet teknike të nevojshme dhe leja e mjedisit po aplikohet pasi ky aktivitet kërkon të funksionojë me vetë nga një subjekt i pavarur për një nga depozitat egzistuese .

Prona ku zhvillohet aktiviteti ka një sipërfaqe prej 31983 m² dhe depozita e cila kërkon të marrë leje të vecante është depozita nr 2 ka një kapacitet egzistues prej rreth 5808,679 m³.

Në ambjentin e punës janë instaluar të gjitha pajisjet zjarr-fikese me infrastrukturen e nevojshme për të qenë një sistem i pa varur dhe shumë eficient.

1 PERSHKRIMI I PROJEKTIT

1.1 Te pergjithshme mbi aktivitetin

Shoqëria "EUROPETROL EXPORT " Sh.a, me administrator Z.Arlind Fida do te vijoje ushtrimin e aktivitetit tregtim e shitje me shumice te karburantit ne ambientet e aktivitetit te depozitimit dhe tregtimit me shumice te naftes dhe nenprodukteve te saj, aktiviteti ndodhet ne pronesi te shoqerise "EUROTANK " Sh.a me te cilen disponon nje kontrate qeraje date 02.03.2021 PER DEPOZITEN NR.2 te kesaj prone.

Te gjitha tubacionet brenda terminalit jane vendosur mbi bazamente betoni me shtrat celiku, ku perfshihet instalimi i tubacionit hyres me diameter 4" ndermjet depozitave dhe pompes shkarkuese ne stacionin e pompave.

Terminali eshte i ndare ne keto pjese kryesore

- Zona e depozitimit te naftes dhe nenprodukteve te saj
- Salla e kompresoreve/pompave
- Sistemi i mbrojtjes nga zjarri
- Repartet ndihmese

• **Kolektori i shperndarjes se produktit**

Ky kolektor perbehet nga nje seri tubacionesh dhe saracineskash qe lejojne mbushjen dhe zbrazjen e cdo depozite nga produkti si dhe kalimin e produktit nga nje depozite tek tjetra.

• **Parku i depozitave**

Depozitat e hidrokarbureve jane te llojit cilindrike — vertikale me fund te sheshte dhe cati konike e llojit te lemuar.

• **Salla e komandes**

Salla e komandes sherben per monitorimin 24 ore/dite te te gjithë procesit te funksionimit teknologjik te impiantit.

• **Stacioni i pompave**

Moduli i pompimit perbehet nga dy pompa centrifugale 2 x 1000, te montuara ne paralel, te cilat nuk punojne ne te njejten kohe dhe fumizojne nje monitor te vetem filtri per ngarkimin e furnizuesit te karburantit.


• **Sistemi i mbrojtjes nga zjarri**

Ne terminal eshte ndertuar nje depozite me kapacitet 100 m³ e cila do te perdoret per furnizimin me uje te sistemit te mbrojtjes nga zjarri. Rrjeti i tubacioneve te sistemit te mbrojtjes ndaj zjarrit eshte i shtrire ne te gjithë hapësirën e terminalit dhe i perbere nga tuba celiku me karbon. Ky sistem funksionon per te mbuluar te gjithë pronen pjese e te ciles este edhe depozita nr.5.

1.2 Vendodhja e aktivitetit

Aktiviteti i subjektit, do te ushtrohet prane zones "Porto Romano", fshati Rinia, Njesia Administrative Katund i Ri, Durres. Objekti ndodhet ne nje distance minimale rreth 0,5 km larg nga shtepite e banimit. Shih harten e meposhtme.

Pamje satelitore e objektit ne vleresim



2 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT PER MINIMIZIMIN E TYRE

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone kundrejt ketij aktiviteti egzistues do te vleresohen ne fazen e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i paisjeve dhe linjes teknologjike.

Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoj te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Ndikimet e pritshme ne mjedis te analizuara gjate fazes se operimit te instalimit mund te permbledhen si me poshte:

1. Shkarkimet ne ujera vijne nga:

- a) proceset e ftohjes (kondensimit),
- b) ujrata e perdorura per qellime sanitare.

Lidhur me ujrata që vijnë nga përdorimi sanitar, ato nuk duhet të përzihen me ujrata industriale, por duhet të kalojnë në sistemin kanalizues dhe të lidhen me kolektorin e qytetit.

Duke respektuar procesin teknologjik, mundësitë e ndotjes nga ujërat e shkarkimit do të jenë të papërfilleshme.

2. **Ndotja e tokës** si rezultat i rrjedhjeve të ndryshme gjatë ngarkimit dhe shkarkimit të automjeteve apo makinerive, apo në rast të emergjencave të mundshme;

Minimizimi i ndikimit në mjedis lidhet me shkallën e trajnimit dhe ndergjegjesimit të punonjësve të kompanisë për të mos lejuar furnizuesit apo çdo firmë kontraktuese që siguron furnizimin me lëndë të parë, të shkaktojë rrjedhje të lëndës së parë në tokë. Kompanitë e kontraktuara duhet të detyrohen të përdorin pajisje të posaçme, që nuk lejone derdhjet e produkteve të naftës gjatë ngarkimit dhe shkarkimit të tyre. Gjithashtu sipërfaqja e tokës ku automjetet kryejnë ngarkimin dhe shkarkimin e lëndës së parë duhet të jetë e betonuar.

3. **Ndotja e ajrit** vjen gjatë procesit të riciklimit:

- a) si rezultat i avullimit të komponimeve hidrokarbure të avullueshme nga rrjedhjet e ndryshme dhe
- b) djegia e lëndës djegëse të gaztë.

Nga rrjedhjet e mundshme të nënprodukteve të naftës ndodh jo vetëm kontaminimi i tokës, por për shkak të avullimit të hidrokarbureve ndodh edhe ndotja e ajrit nga komponimet organike. Impianti është dizenuar në mënyrë të tillë që të ketë depozite të jetë e pajisur me element sigurie. Duke monitoruar shkarkimet në ajër, kompania vlerëson edhe efektivitetin e filtrave që duhet të përdori, për të evituar ndotjen e ajrit në mjedis.

Një avantazh i kompanisë është edhe fakti që impianti do të instalohet në një zonë industriale, ku ndikimi i pritshëm në mjedis dhe shëndet nga ky aktivitet është i ulët.

Siguria dhe ndikimet e pritshme në shëndet shkaktohen nga:

1. Rreziku nga **zjarri**
2. Rreziqet nga **aksidentet industriale**

Si çdo aktivitet tjetër industrial edhe në këto raste, megjithë shkallën e sigurisë që ka vetë dizinimi i impiantit, masat e sigurisë shtesë të marra nga kompania janë të domosdoshme, për të evituar rreziqet në mjedis dhe shëndet që vijnë nga zjarri për shkak të aksidenteve së bashku me trajnimin e punonjësve dhe zbatimin e rregullores teknike.

Në objekt janë të instaluar të gjitha pajisjet dhe infrastruktura e nevojshme për zbatimin e kushteve teknike dhe të sigurta. Kushtet e punës janë me standarte sigurie duke qenë se ky aktivitet është egzistues .

Së bashku me funksionimin sa më të sigurt të enëve me presion në këto aktivitet i cili përveç magazinimit dhe tregtimit me shumicë kryen edhe shitje me pakicë është e nevojshme edhe përshtatshmeria e pajisjeve të transportit të produktit të mbetjeve të rrezikshme.

3 Propozimi masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve negative ne mjedis

Masat qe duhen konsideruar per te minimizuar ndikimin ne mjedis jane:

- a) Duhet te tregohet kujdes ne respektimin rigoroz te kushteve teknike ne objekt per te reduktuar mundesite e renies se zjarrit ne objekt dhe avarite ne sistem duke shmangur shperndarjen e produktit ne mjedisin e zones perreth. Djegia e lendes se depozituar eshte teper e demshme per mjedisin e zones dhe banoret e zones, te cilet kane si nje nga menytrat kryesore te mbijeteses perdorimin e tokave bujqesore.
- b) Mbetjet hidrokarbure te ndara te grumbullohen dhe te dergohen per perpunim ne subjektet e licensuar per kete qellim.
- c) Lidhur me mbetjet nga teknologjia dhe ato te derguara per perpunim duhet qe kompania te kete nje database te sasive qe grumbullohen si dhe duhet te kontraktoje nje kompani per largimin e tyre ne ambiente te pershtatshme per perpunimin e tyre.
- d) Sasia depozituese te mos i kaloje volumet e parashikuara ne menyre qe situata te jete e kontrollueshme.
- e) Te zbatohet projekti i mbrojtjes nga zjarri ne menyre qe te perballoje sasine e depozituar te lendes djegese ne raste te avarive te ndryshme.
- f) Punonjesit te jene te trajnuar paraprakisht dhe te jene vazhdimisht ne mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjate proceseve te punes. Punimet e mirembajtjes te kryhen ne perputhje me kushtet teknike te punes.
- g) Te kete te punesuar me kohe te plote nje drejtues teknik per vzhgimin e funksionimit te aktivitetit.